



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
KABINETI

**NJOFTIM PËR SHTYP**

**Rasti:** Krijimi i një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëria Magna Metalforming GmbH dhe LG Electronics Inc.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar shkresa nr.58 prot., i AK, datë 22.01.2021 “Përqendrim nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota midis Magna Metalforming GmbH dhe LG Electronics Inc.- Njoftim në përputhje me ligjin për mbrojtjen e konkurrencës.”, me të cilën jemi njoftuar mbi transaksionin e krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëria Magna Metalforming GmbH dhe LG Electronics Inc.

Palët në marrëveshje janë:

**LG Electronics INC (LGE)**, shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Koresë dhe objekti i veprimtarisë së shoqërisë është të prodhojë dhe të shesë makineri dhe pajisje elektronike, elektrike dhe të komunikimit; të prodhojë, shesë dhe të japë me qera pajisje software dhe hardware, pajisje transmetimi, të komunikimit satelitor, rrjete të komunikimit, rrjete audio/video etj, pajisje optike, përfshirë edhe kamerat etj.

**Magna Metalforming GmbH**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Austrisë, me aktivitet kryesor mbajtjen dhe administrimin e pjesëmarrjeve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta në shoqëritë aktive në biznesin e propulsorit motorik.

**LG Magna e-Powertrain Co.,Ltd**, një ndërmarrje e përbashkët me funksione të plota (joint-venture) e cila ka për qëllim të kërkojë, të projektojë, zhvillojë, ndërtojë, validojë, prodhojë, montojë, shesë dhe shpërndajë (i) produkte përbërëse (komponentë), (ii) sisteme e-drive dhe (iii) sisteme inverter. Pas përfundimit të transaksionit, JV-ja do të përpiqet të shesë produktet përbërëse globalisht. JV-ja do të kryejë, mbi një bazë afatgjatë, të gjitha funksionet e një subjekti ekonomik autonom.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenet 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**